

AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE
“VILA DEA” SH.P.K

Sot, më datë 18.04.2024, unë i nënshkruari:

Eno Seferi, datëlindja 14.04.1984 lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.personal I40414072V;

bazuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” *vendosa* të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**VILA DEA**” sh.p.k, sipas parashikimeve të mëposhtme:

NENI 1
Emri i shoqërisë

Emërtimi i Plotë i Shoqërisë Tregtare është “**VILA DEA**” sh.p.k.

NENI 2
Selia e shoqërisë

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Tiranë, në adresën: Njësia Administrative Farkë, Rruga “Ullishta”, Pallati Primavera, Kati 1, Zona Kadastrale 3266, Nr. Pasurie 96/64-N2, Tiranë.

NENI 3
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- Agroturizëm, Administrim pasurish, Dhënie me qera Vila dhe Apartamente, Real Estate. Shoqëria mund të financohet nga shoqëri private vëndase dhe të huaja.

NENI 4
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në të holla i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, me vlerë 10,000 (dhjetë mijë) LEKË. Kapitali themeltar përbëhet nga 1 (një) kuotë:

Ortaku themelues Eno Seferi, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 10,000 (dhjetëmijë) lekë, i cili zotëron 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kapitali themeltar do te shlyhet nga ortaku themelues në llogarinë bankare të Shoqërisë, pas regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare të Biznesit. Nje kopje e mandat pagesës bankare te shlyerjes se kapitalit themeltar nga ana e Ortakut të Shoqërisë, depozitohet ne Qendrën Kombëtare të Biznesit si deklarim vullnetar nga Administratori i Shoqërisë.

NENI 5 **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 6 **Organet Drejtuese**

Ne zbatim te Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të Shoqërisë janë si më poshtë vijon :

1. Asambleja e Përgjithshme – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë;

Mënyra e organizimit dhe funksionimit te ketyre organeve rregullohet dhe ushtrohet sipas parashikimeve të Statutit te Shoqërisë dhe legjislacionit ne fuqi.

Shoqëria do të perfaqësohet ligjërisht nga Administratori i saj i cili është **Eno Seferi** atësia Valter, i datëlindjes 14.04.1984, lindur dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal I40414072V.

NENI 7 **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

Me nënshkrimin e ketij Akt Themelimi, ortaku themelues detyrohet që të hartojë dhe nënshkruajë Statutin e Shoqërisë, një kopje e të cilit do të depozitohet në QKB.

Ngarkohet Administratori i Shoqërisë që të kryejë procedurat e Regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombetare të Biznesit. Këtë detyrim, Administratori mund ta kryejë personalisht, ose me anë personave të caktuar prej tij me Autorizim ose Prokurë të Posaçme.

Ortaku Themelues

Eno SEFERI


2